



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1345/13 prot.,

Datë 08.06.2026

V E N D I M

Nr. 764 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtare

Në mbledhjen e datës 08.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.719/2026, datë 28.05.2026, për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar (Punë Publike)”, me Nr. REF-80616-04-01-2026, me objekt “Furnizim-Vendosje Semaforë”, me fond limit 2,807,500 (dy milion e tetëqind e shtatë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 14.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz.
- Ankimues:** OE “R. S. & M” Shpk me NUIS K32203002I, me adresë: Tiranë, AUTOSTRAD KM 2,.
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz, me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr. 492, Kamëz.
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION Sh.p.k”, me NUIS K51408016J, me adresë: Vore Tirane, Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Bexulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 28.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.719/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “R. S. & M” SHPK, për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar (Punë Publike)”, me Nr. REF-80616-04-01-2026, me objekt “Furnizim-Vendosje Semaforë”, me fond limit 2,807,500 (dy milion e tetëqind e shtatë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 14.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorin ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ R. S. & M” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 770 prot., datë 01.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1345/10 prot., datë 05.06.2026, autortiteti kontraktor Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 719/2026, datë 28.05.2026.

-Urdhërin e autoritetit kontraktor me nr.767 prot., datë 29.05.2026;

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 767/1 prot., datë 01.06.2026, të nënshkruar nga anëtarët e NJP;

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 767/2 prot., datë 01.06.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën përcjellëse me nr. 770 prot., datë 01.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1345/10 prot., datë 05.06.2026, autortiteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 719/2026, datë 28.05.2026.

-Urdhërin e autoritetit kontraktor me nr.767 prot., datë 29.05.2026;

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 767/1 prot., datë 01.06.2026, të nënshkruar nga anëtarët e NJP;

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 767/2 prot., datë 01.06.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së;

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 770 prot., datë 01.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1345/10 prot., datë 05.06.2026, nëpërmjet shërbimit postar, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.719/2026, datë 28.05.2026.

Autoriteti kontraktor ka rivlerësuar arsyet e skualifikimit për OE “*I.D.K-KONSTRUKSION SHPK* dhe është ndryshuar në statusin “I Skualifikuar”, në fazën e vlerësimit të datës 20.04.2026, referuar edhe arsyetimit të bërë në vendimin e KPP 791/2026 Datë 28.05.2026, ku sipa së cilës gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik (subjekt i interesuar) “*I.D.K-KONSTRUKSION*” ShPK, ka qenë e “Skualifikuar”.

Më tej me publikimin e njoftimit të fituesit paraprak, dhe këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar, duke bashkëlidhur edhe procesverbalit të rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 767/2 prot., datë 01.06.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar (Punë Publike)”, me Nr. REF-80616-04-01-2026, me objekt “Furnizim-Vendosje Semafore”, me fond limit 2,807,500 (dy milion e tetëqind e shtatë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 14.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2026/06/09 14:46:42 +02'00'
f17320abdbba4055855d2ae2d832f8cb20260609144640
72020

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2026.06.09
03:33:17